

**Vendim nr. 28 datë 11.04.2024**

**(V-28/24)**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Elsa Toska, Sonila Bejtja, Genti Ibrahim, Marjana Semini, Sandër Beci, anëtarë, me sekretare Belma Lleshi, në datën 11.04.2024 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 14 (K) 2023 të Regjistrimit Themeltar, që u përket:

**KËRKUESE:**           **KESTRIN KATRO**, përfaqësuar nga avokat Erind Merkuri, me prokurë.

**SUBJEKT I INTERESUAR:**

**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**, përfaqësuar nga kryetarja Nureda Llagami.

**OBJEKTI:**           **Shfuqizimi i vendimeve nr. 22, datë 07.03.2023 të Gjykatës Administrative të Apelit; nr. 00-2023-762, datë 09.03.2023 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Shfuqizimi i nenit 32, pika 2, të ligjit nr. 96/2016, datë 06.10.2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

**BAZA LIGJORE:**   **Nenet 42, 49, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i” dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (Kushtetuta); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ); nenet 71 dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).**

**GJYKATA KUSHTETUESE,**

pasi dëgjoji relatorin e çështjes Sandër Beci, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkueses, e cila ka kërkuar pranimin e kërkesës, parashtrimet me shkrim të subjektit të interesuar, Këshillit të Lartë Gjyqësor (KLGJ), i cili ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

## **V Ë R E N:**

### **I**

#### **Rrethanat e çështjes**

1. Me vendimet nr. 108 dhe nr. 109, datë 09.07.2019, si dhe nr. 172, datë 11.09.2019, KLGJ-ja ka vendosur shpalljen e procedurës së emërimit në Gjykatën e Lartë dhe thirrjen për paraqitjen e kandidaturave, nga radhët e juristëve të spikatur, për tre pozicione të lira që plotësonin kërkesat për ekspertizë të veçantë në fushën e së drejtës administrative (një pozicion) dhe të drejtës civile (dy pozicione). Për këto pozicione ka aplikuar pranë KLGJ-së edhe kërkuesja.

2. Me vendimin nr. 182, datë 02.10.2019, KLGJ-ja ka vendosur se për kërkuesen, e cila ka aplikuar edhe për pozicionet e shpallura me vendimet e KLGJ-së nr. 108, nr. 109 dhe nr. 110, datë 09.07.2019, procedurat e verifikimit që janë në proces e sipër për këto kandidime janë të vlefshme edhe për kandidimet në pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 172, datë 11.09.2019.

3. Pas kryerjes së verifikimeve për plotësimin e kriterëve ligjore të kandidimit, për kërkuesen është kërkuar raportim nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI) për sa i përket kriterit të pasurisë. ILDKPKI-ja i ka dërguar KLGJ-së raportin nr. 109/24 prot., datë 28.10.2019, sipas të cilit: i) deklarimi i kërkueses nuk është i saktë në përputhje me ligjin; ii) ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar pasurinë; iii) ka mosdeklarim të pasurisë; iv) nuk ka kryer deklarim të rremë; v) ka përfituar të ardhura në kundërshtim me ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar. Ky raport i është njoftuar kërkueses në rrugë elektronike nga KLGJ-ja dhe ajo ka paraqitur pretendimet e shpjegimet e saj në lidhje me gjetjet e ILDKPKI-së. Nisur nga shpjegimet dhe dokumentet mbështetëse të paraqitura nga kërkuesja, KLGJ-ja i ka kërkuar ILDKPKI-së informacion shtesë, duke i përcjellë edhe këtë dokumentacion mbështetës. Në përfundim të veprimeve verifikuese, ILDKPKI-ja ka përcjellë në KLGJ raportin shtesë nr. 109/25, datë 02.12.2019, sipas të cilit: i) deklarimi i bërë nga kërkuesja nuk është i saktë në përputhje me ligjin; ii) ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor për të justifikuar pasurinë; iii) ka mosdeklarim të

pasurisë; iv) nuk ka kryer deklarin të rremë; v) nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit. Pasi u njoh me gjetjet e kësaj procedure, kërkuesja ka depozituar pretendimet e saj në KLGJ, duke i shoqëruar me dokumentacionin përkatës.

4. Në datën 30.12.2019 Komisioni i Zhvillimit të Karrierës në KLGJ, duke e konsideruar të plotë procedurën dhe verifikimet e kryera për kushtet dhe kriteret e kandidimit të kërkueses, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në mbledhjen e KLGJ-së. Kjo fundit, me vendimin nr. 41, datë 23.01.2020, ka vendosur skualifikimin e kërkueses dhe përjashtimin e saj nga kandidimi si gjyqtare në Gjykatën e Lartë, me arsyetimin se ajo nuk ka bërë deklarin të saktë në përputhje me ligjin, ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar pasurinë, për shkak se nuk ka arritur të provojë me dokumentacion justifikues ligjor vlerat e investuara, burimet financiare dhe periudhat kur janë bërë këto investime dhe ka mosdeklarin të pasurisë. Duke mos qenë dakord me vendimin, kërkuesja ka paraqitur kërkesëpadi në Gjykatën Administrative të Apelit.

5. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 32, datë 21.02.2020, ka vendosur rrëzimin e padisë, vendim që është prishur nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2021-1229 (88), datë 24.06.2021, duke e kthyer çështjen për rishqyrtim në atë gjykatë, me tjetër trup gjykues. Sipas Kolegjit Administrativ, duke mos lejuar kryerjen e aktit të ekspertimit të kërkuar prej paditëses (kërkueses) në mënyrë të përsëritur gjatë procedurave administrative dhe gjyqësore, si dhe duke mos i dhënë përgjigje të argumentuar pretendimeve kryesore të saj, i është rënduar pozita procedurale në cenim të parimit të kontradiktoritetit. Kolegji Administrativ ka vlerësuar se mungesa e hetimit të plotë dhe të gjithanshëm gjatë procedurave administrative nuk është riparuar as gjatë gjykimit të mosmarrëveshjes në Gjykatën Administrative të Apelit, e cila duhej të vlerësonte, në funksion të debatit gjyqësor, nëse pretendimet për parregullsinë e procesit ligjor në KLGJ kishin një bazë të mjaftueshme për të arsyetuar në mënyrë të plotë dhe për të konkluduar përfundimisht për rastin në shqyrtim.

6. Në rigjykimin e çështjes, Gjykata Administrative e Apelit ka administruar, në cilësinë e provës shkresore, aktin e ekspertimit të ekspertes M.N. Në përfundim, me vendimin nr. 22, datë 07.03.2022, Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë, duke arsyetuar se pala e paditur (KLGJ), me të drejtë, ka arritur në përfundimin se paditësja si kandidate për gjyqtare në Gjykatën e Lartë nuk e përmbush kriterin e vlerësimit të pasurisë, e, për pasojë, me të drejtë është skualifikuar nga kandidimi, pasi ka rezultuar se ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar pasurinë, sepse nuk ka arritur të provojë me dokumentacion justifikues ligjor vlerat e investuara, burimet financiare dhe periudhat kur janë

bërë këto investime (*shih faqen 71 të vendimit të gjykatës së apelit*). Kundër këtij vendimi kërkuesja ka ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë.

7. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-762, datë 09.03.2023, në dhomën e këshillimit, ka vendosur mospranimin e rekursit për shkak se nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 58 i ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar (*ligji nr. 49/2012*). Sipas Kolegjit Administrativ, pretendimet e kërkueses janë të pabazuara dhe Gjykata Administrative e Apelit, në rigjykim, ka plotësuar kërkesat e lëna nga Gjykata e Lartë.

8. Në datën 10.07.2023, nëpërmjet shërbimit postar, kërkuesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas parashikimeve të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 28.07.2023. Kolegji i Gjykatës në datën 22.11.2023 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

9. Në datën 01.03.2024 një prej anëtarëve të Gjykatës ka paraqitur kërkesë për heqjen dorë nga shqyrtimi i çështjes, për shkak se ndodhej përpara rastit të parashikuar nga neni 36, pika 1, shkronja “ç”, të ligjit nr. 8577/2000 dhe nenit 18, pika 1, shkronja “c”, të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, e cila u pranua nga Mbledhja e Gjyqtarëve me vendimin nr. 6, datë 03.04.2024.

## II

### Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

10. **Kërkuesja**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se gjatë procesit administrativ dhe atij gjyqësor i është cenuar e drejta për proces të rregullt në drejtim të:

10.1. *Së drejtës së aksesit në funksione publike të lidhur me parimin e proporcionalitetit dhe të sigurisë juridike*, pasi Gjykata e Lartë, në rastin e kërkueses, ka devijuar nga praktika e saj e mëparshme (*shih vendimin nr. 00-2022-3674 (416), datë 06.12.2022 të Kolegjit Administrativ*), sipas së cilës “*pala paditëse ishte në gjendje të argumentonte që akti objekt gjykimi nuk e ka respektuar këtë parim, që nuk është një akt i nevojshëm dhe se nuk janë mbajtur në konsideratë nga pala e paditur zhvillimi historik dhe situata ekonomike në vendin tonë*”. Kërkuesja pretendon se është penguar të kandidojë në Gjykatën e Lartë edhe për procedurat e tjera që mund të zhvillohen në të ardhmen, duke qenë se është përjashtuar për kriterin e pasurisë. Vendimmarrja e Gjykatës është një mjet për rivendosjen e së

drejtës, pasi në rastin eventual të rikthimit për rigjykim dhe fitimit të çështjes, asaj i lind e drejta e shpërblimit të dëmit.

- 10.2. *Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj*, për shkak se gjyqtari F.K. që ka gjykuar çështjen në Gjykatën Administrative të Apelit nuk ka qenë i emëruar si gjyqtar në atë gjykatë, por ka qenë gjyqtar në gjykatën e shkallës së parë, për rrjedhojë ai nuk i kishte tagrat dhe kompetencën për të vendosur si një gjyqtar i Gjykatës Administrative të Apelit.
- 10.3. *Parimit të paanshmërisë*, pasi dy nga anëtarët e trupit gjykues në Gjykatën Administrative të Apelit, konkretisht gjyqtarët E.M. dhe F.K., ishin në një marrëdhënie të posaçme me palën e paditur (KLGJ-në), duke qenë se kishin aplikuar për ngritje në detyrë brenda pushtetit gjyqësor. Gjatë kohës që kjo çështje ishte në gjykim në Gjykatën Administrative të Apelit, KLGJ-ja ka hapur procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë për tre pozicione, ku rezultoi se gjyqtarja E.M. është emëruar në një prej tyre. Kërkesa për heqjen dorë nga gjykimi i kësaj gjyqtareje është ngritur edhe në gjykatën e apelit. Edhe gjyqtari F.K., i komanduar për gjykimin e çështjes së kërkueses, ka aplikuar për ngritje në detyrë në tre gjykata apeli, përfshirë edhe Gjykatën Administrative të Apelit që ka gjykuar çështjen e kërkueses dhe në përfundim të procedurës është ngritur në detyrë duke u emëruar në një gjykatë apeli. Ky fakt është bërë i ditur vetëm pas përfundimit të gjykimin të çështjes. Ky parim është cenuar edhe nga gjyqtarja A.N., e cila ka shqyrtuar kërkesën e kërkueses për heqjen dorë nga gjykimi të gjyqtarës E.M., të bërë për shkaqe të ndryshme nga ato më sipër. Gjyqtarja A.N. ka qenë pjesë e trupit gjykues të gjykatës së apelit që ka dhënë vendimin që është prishur nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, i cili e ka kthyer çështjen për rigjykim.
- 10.4. *Parimit të barazisë së armëve dhe së drejtës për t'u dëgjuar*, pasi ILDKPKI-ja dhe KLGJ-ja nuk i kanë vlerësuar shkresat në tërësinë e tyre, por të ndara, për të mos thënë që nuk i kanë analizuar fare. Raportet e organeve tatimore janë mbajtur në vitet 2004 dhe 2006 dhe tregojnë marrëdhëniet juridike që kanë ndodhur në atë kohë. Duke qenë dokumentacion i mbajtur në ato vite, është e qartë se mënyra e mbajtjes së tyre nuk ka asnjë lidhje me mënyrën e vlerësimit të kandidatëve në kohën e sotme. Për këtë arsye vërtetësia e tyre nuk mund të vihet në diskutim.
- 10.5. *Parimit të barazisë para ligjit*, pasi Gjykata e Lartë, në një rast të ngjashëm, kur nga Gjykata Administrative e Apelit ka pasur tre mendime të ndryshme, ka

kërkuar aplikimin e nenit 307, paragrafi i tretë, të Kodit të Procedurës Civile (KPC) (vendimi nr. 00-2022-1717 (265), datë 07.07.2022 i Kolegjit Administrativ). Ky parim është cenuar edhe nga KLGJ-ja, pasi edhe prej saj janë aplikuar standarde të dyfishta për raste të ngjashme (vendimi për vlerësimin e një kandidati për magjistrat nr. 254, datë 12.11.2019).

10.6. *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk ka parashtruar si shkaqe rekursi disa nga pretendimet e kërkueses. Gjithashtu, vendimi i Kolegjit Administrativ nuk ka qëndrim në lidhje me pretendimet për procesin në gjykatën e apelit, duke qenë se vendimi i kësaj të fundit përmbante tre qëndrime të ndryshme nga tre anëtarët e trupit gjykues (mendimin e shumicës, mendimin paralel dhe mendimin kundër). Në këtë drejtim, Kolegji Administrativ nuk ka arsyetuar në lidhje me zbatueshmërinë e nenit 307, paragrafi i tretë, të KPC-së. Ky standard është cenuar edhe nga Gjykata Administrative e Apelit, pasi nga përmbajtja e vendimit të saj nuk rezulton se ka një vendimmarrje konkrete, për shkak të pasjes së tre mendimeve të ndryshme, shumicë, kundër dhe paralel. Në rastin konkret, duke pasur tre mendime të ndryshme, nuk ka asnjë konkluzion në lidhje me vlerësimin e aktit të ekspertimit, për të cilin Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur rigjykimin e çështjes, që ai të merrej si provë në gjykim. Qëndrim kontradiktor ka edhe për sa i përket vlerësimit në lidhje me praktikën e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe faktit nëse pasuria e kërkueses është e ligjshme ose jo.

10.7. *Së drejtës për punë dhe profesion*, pasi ligjvënësi që nga viti 1993 nuk e konsideron të nevojshme mbajtjen e dokumentacionit kontabël nga subjektet tregtare më shumë se 10 vjet. Megjithatë, kërkuesja është penalizuar se nuk ka arritur të sjellë dokumentacionin kontabël të shoqërive tregtare për këtë periudhë 10-vjeçare. Mënyra se si është interpretuar ligji nga KLGJ-ja, Gjykata Administrative e Apelit dhe Gjykata e Lartë ka sjellë një kufizim joproportional të së drejtës së kërkueses për punë. E vetmja mënyrë interpretimi e kësaj dispozite është që verifikimi i pasurisë të përfshijë të gjithë periudhën për të cilën ekziston detyrimi për ruajtjen e dokumentacionit kontabël. Në rast se e vetmja formë interpretimi mbetet verifikimi i pasurisë së kandidatëve në mënyrë të pakufizueshme, atëherë neni 32, pika 2, i ligjit nr. 96/2016, datë 06.10.2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar

(ligji nr. 96/2016), rezulton të jetë antikushtetues, pasi kufizon në mënyrë joproporcionale të drejtën për punë dhe profesion.

11. **Subjekti i interesuar, KLGJ-ja**, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar si vijon:

*A) Për legjitimimin*

11.1. Kërkuësja nuk ka shteruar mjetet juridike efektive për pretendimet e saj për cenimin e *parimit të paanshmërisë dhe të së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj*, pasi, bazuar në dispozitat e KPC-së, ajo ka pasur mundësi të kundërshtonte përbërjen e trupit gjykues por nuk e ka bërë një gjë të tillë. Pretendimi se ajo nuk ka qenë në dijeni se dy nga anëtarët e trupit gjykues kishin aplikuar për ngritje në detyrë nuk qëndron, pasi ky është një informacion publik dhe ajo nuk mund të justifikohet me padijeninë e saj.

*B) Për themelin*

11.2. Pretendimi për cenimin e *së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj* është i pabazuar, pasi në rastin e çështjes së kërkuëses është konstatuar mungesa e padisponueshmërisë ligjore të të gjithë anëtarëve të Gjykatës Administrative të Apelit dhe për këtë arsye zëvendëskryetari i saj i është drejtuar KLGJ-së me kërkesë për caktimin e gjyqtarit për shqyrtimin e çështjes. Me vendimin nr. 512, datë 26.10.2021 të KLGJ-së, gjyqtari F.K., i cili ka qenë gjyqtar i deleguar në Gjykatën e Apelit Durrës (sipas vendimit nr. 525, datë 27.10.2020), është caktuar në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës Administrative të Apelit çështjen e kërkuëses. Ky delegim është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi.

11.3. Pretendimi i kërkuëses për cenimin e *parimit të paanshmërisë* është i pabazuar, pasi vetëm fakti se gjyqtarët kanë aplikuar për ngritje në detyrë nuk mjafton për të mbështetur pretendimet për paanshmëri të tyre. Këtij pretendimi i është dhënë përgjigje e arsyetuar nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë në mënyrë shteruese, sipas të cilit pretendimi është hipotetik dhe nuk krijon dyshime të arsyeshme për paanësinë e gjyqtarit. Edhe pretendimi tjetër i kërkuëses, që lidhet me gjyqtaren që ka shqyrtuar kërkesën për përjashtimin e gjyqtarit, nuk është i bazuar, pasi arsyeja për të cilën ka ngritur pretendimet e saj nuk përfshihet në asnjë prej dispozitave të nenit 72 të KPC-së.

11.4. Pretendimet për cenimin e *parimit të barazisë së armëve dhe të së drejtës për t'u dëgjuar* nuk hyjnë në juridiksionin kushtetues, pasi, në thelb, kanë të bëjnë me çmuarjen e provave nga KLGJ-ja dhe Gjykata Administrative e Apelit, ndaj nuk

mund të merren në shqyrtim nga Gjykata. Gjithsesi, këtyre pretendimeve u është dhënë përgjigje e arsyetuar nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë. Kërkueses i është garantuar e drejta për t'u dëgjuar në procesin administrativ të zhvilluar nga KLGJ-ja. Ajo është njohur me aktet e nxjerra nga organet e përfshira në proces, për të cilat ka paraqitur disa herë shpjegimet e saj dhe dokumentet shoqëruese. Gjithashtu, Gjykata Administrative e Apelit ka bërë pjesë të procesit gjyqësor edhe ekspertin e kërkuar nga vetë kërkuesja, duke plotësuar detyrat e lëna nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë. Bazuar në jurisprudencën kushtetuese, mendimi i ekspertit nuk është i detyrueshëm për gjykatën.

11.5. I pabazuar është edhe pretendimi për cenimin e *parimit të barazisë përpara ligjit*, pasi vendimi i ngjashëm i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë i përmendur nga kërkuesja i referohet rastit kur mendimi i gjyqtarit paralel ka shfaqur kundërshti me pjesën urdhëruese të vendimit gjyqësor dhe jo alternativë të pjesës përshkruese-arsyetuese. Në rastin e paraqitur nga kërkuesja, mendimi i gjyqtarit ka qenë mendim kundër dhe jo mendim paralel, pasi konkurronte me dispozitivin e vendimit dhe jo me arsyetimin e tij. Ndërkohë, ndryshe paraqitet rasti i kërkueses, ku mendimi paralel konkurren vetëm me pjesën arsyetuese të vendimit dhe jo me dispozitivin. KLGJ-ja në asnjë rast nuk ka mbajtur standarde të dyfishta, për shkak se kandidatët e tjerë që kanë aplikuar pranë saj kanë qenë në kushte të ndryshme me kërkuesen.

11.6. Pretendimi për cenimin e *standardit të arsyetimit* është i pabazuar, pasi Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë u ka dhënë përgjigje shteruese pretendimeve të kërkueses për cenimin e procesit të rregullt ligjor. Pretendimet e kërkueses të ngritura në rekurs, jo vetëm që janë pasqyruar në mënyrë të përmbledhur në vendim, por janë trajtuar nga Kolegji Administrativ, vendimi i të cilit është i qartë, logjik dhe nuk ka kundërthënie, duke plotësuar standardet e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese. Edhe Gjykata Administrative e Apelit e ka respektuar këtë standard, pasi vendimi i saj është marrë me shumicë votash, ku një nga anëtarët ka qenë me mendim pakice, ndërsa një tjetër, i cili ka qenë në shumicë, ka arsyetuar me mendim paralel. Që në fjalitë e para të mendimit paralel gjyqtari që ka mbajtur këtë qëndrim ka theksuar se vendimi i KLGJ-së për skualifikimin e kërkueses është i bazuar në ligj. Gjithashtu, i njëjti gjyqtar (i mendimit paralel) rezulton se ka votuar që padia të rrëzohet si e pabazuar në ligj dhe në prova (paragrafi 4, faqja 75, i vendimit). Gjyqtari me mendim paralel ka votuar kundër



vetëm për sa i përket disponimit në pjesën e dispozitivit të vendimit përfundimtar për lejueshmërinë ose jo të rekursit. Në këtë kuptim vërehet qartë se vendimi i gjykatës së apelit është marrë me shumicën e nevojshme të votave të gjyqtarëve. Ai vendim ka respektuar standardet kushtetuese për arsyetimin, si dhe u ka dhënë përgjigje të detajuar të gjitha pretendimeve të kërkuases. Ai është logjik, i qartë dhe jokontradiktor. Nga ana tjetër, pretendimet e kërkuases në drejtim të këtij pretendimi, në thelb, kanë të bëjnë me interpretimin e ligjit dhe zgjidhjen e çështjes, të cilat nuk hyjnë në juridiksionin kushtetues të Gjykatës.

11.7. Në lidhje me pretendimin për cenimin e *së drejtës për punë dhe profesion*, kërkuësja nuk ka arritur të argumentojë se zbatimi i parashikimeve ligjore të nenit 32, pika 2, të ligjit nr. 96/2016 përbën cenim të këtyre parimeve. Bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenin 71 të ligjit nr. 8577/2000, ajo nuk legjitimohet në kërkesën e saj për shfuqizimin e kësaj dispozite.

### III

#### Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

##### A. Për legjitimitimin e kërkuases

12. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

13. Në këtë këndvështrim, kërkuësja, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “f” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi është palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi.

14. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në jurisprudencën e saj Gjykata ka vërejtur se ai përcaktohet nga nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe neni 71/a, pika 1, shkronja “a”, i ligjit nr. 8577/2000. Ky

kriter përbën parakusht që duhet përmbushur nga kërkuesi, i cili para se t'i drejtohet Gjykatës duhet të vërtetohet se i ka përdorur të gjitha mjetet juridike të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura. Ky rregull nënkupton jo vetëm që individi t'u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, por edhe që të gjitha pretendimet që ngrenë këtë Gjykatë t'i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimet nr. 5, datë 09.02.2023; nr. 12, datë 09.03.2021; nr. 8, datë 19.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Për sa më lart, Gjykata konstaton se kërkuesja në ankimin kushtetues individual ka pasur si pjesë të objektit edhe shfuqizimin e nenit 32, pika 2, të ligjit nr. 96/2016, duke e lidhur atë me cenimin e së drejtës për punë dhe profesion. Ndërsa në prapësimet e saj të datës 08.01.2024, që ka sjellë ndaj prapësimeve të subjektit të interesuar, KLGJ-së, kërkuesja ka parashtruar se pretendimet në lidhje me nenin 32, pika 2, të ligjit nr. 96/2016 nuk janë në objekt të kërkesës, por janë ngritur vetëm si argumente për cenimin e së drejtës për punë dhe profesion.

16. Sipas nenit 31/b, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, kërkuesi mund të heqë dorë nga kërkesa përpara fillimit të shqyrtimit të saj nga Gjykata. Në këtë rast Gjykata vendos pushimin e gjykimit të çështjes. Në kuptim të kësaj dispozite, si edhe prapësimeve të kërkueses të datës 08.01.2024, të sjella ndaj prapësimeve të subjektit të interesuar, Gjykata evidenton se vetë kërkuesja ka hequr dorë nga kërkimi për shfuqizimin e nenit 32, pika 2, të ligjit nr. 96/2016 të lidhur me cenimin e së drejtës për punë dhe profesion. Për këtë arsye, Gjykata çmon se duhet të vendoset pushimi i gjykimit për këtë kërkim.

17. Në lidhje me pretendimet e tjera të ngritura në ankimin kushtetues individual, që kanë të bëjnë me cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, Gjykata vëren se kërkuesja i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm dhe pasi ka shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta. Gjithashtu, Gjykata konstaton se kërkuesja ka ngritur pretendime edhe për procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë, për të cilin nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të saj kushtetuese përveç ankimit kushtetues individual. Për rrjedhojë, në lidhje me këto pretendime, konsiderohet se plotësohet kriteri i shterimit të mjeteve juridike, ndaj pretendimi i subjektit të interesuar, KLGJ-së, për mosplotësimin e këtij kriteri është i pabazuar.

18. Kërkuesja legjitimohet *ratione temporis*, pasi vendimi më i fundit gjyqësor që ka vendosur për çështjen e saj, ai i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, mban datën 09.03.2023, kurse ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 10.07.2023

nëpërmjet shërbimit postar, pra brenda afatit 4-mujor të përcaktuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000.

19. Për sa u përket pretendimeve për cenimin e parimit të sigurisë juridike dhe të proporcionalitetit, për shkak se Gjykata e Lartë në rastin konkret ka devijuar nga praktika e saj e mëparshme, kërkuesja i ka parashtruar para Gjykatës vetëm në aktin e shpjegimeve shtesë të datës 26.12.2023 dhe si të tilla ato përbëjnë shtesë të shkaqeve të ankimit kushtetues. Referuar nenit 1, pika 2, të ligjit nr. 8577/2000 dhe nenit 185 të KPC-së, shkaqet e ankimit kushtetues mund të ndryshohen (shtohen ose pakësohen) deri në momentin që vendoset kalimi i çështjes për shqyrtim në seancë plenare (*shih vendimin nr. 63, datë 20.11.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë, Gjykata çmon se këto pretendime të reja nuk mund të merren në shqyrtim<sup>1</sup>, pasi ato janë paraqitur nga kërkuesja pasi Kolegji kishte vendosur kalimin e çështjes në seancë plenare<sup>2</sup>.

20. Në këndvështrim të legjitimitetit *ratione materiae*, edhe pse Gjykata nuk ka ende një qëndrim për sa i takon zbatimin të nenit 71/a, pika 1, shkronja “ç”, të ligjit nr. 8577/2000, i cili parashikon verifikimin nga ana e Gjykatës të mundësisë për rivendosjen e të drejtave që pretendohen se janë shkelur, si kriter për legjitimitetin e kërkueses, në rastin konkret, duke qenë se shqyrtimi i ankimit kushtetues individual ka të bëjë me vlerësimin e pasurisë së saj, i cili është një kriter i pashërueshëm në të ardhmen, në rast të kandidimit në procedura për pozicione të ngjashme, Gjykata vlerëson se kërkuesja legjitimohet *ratione materiae* për paraqitjen e ankimit kushtetues.

21. Në lidhje me shkaqet e ankimit kushtetues individual të paraqitura nga kërkuesja në këtë gjykim kushtetues, Gjykata vëren se, ndër të tjera, ajo ka pretenduar cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit, duke argumentuar se në një rast të ngjashëm, kur nga Gjykata Administrative e Apelit ka pasur tre mendime të ndryshme, shumicë, kundër dhe paralel, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka kërkuar aplikimin e nenit 307, paragrafi i tretë, të KPC-së. Sipas saj, edhe KLGJ-ja ka aplikuar standarde të ndryshme për raste të njëjta.

---

<sup>1</sup> Gjyqtarja Elsa Toska votoi për pranimin e parashtrimeve shtesë të kërkueses, edhe pse janë shkaqe të reja, me argumentet se: (i) pretendimet janë brenda objektit dhe bazës kushtetuese të përcaktuar në ankimin kushtetues individual të kërkueses; (ii) mohimi i aksesit në lidhje me pretendimet e reja të kërkueses në gjykimin kushtetues, si rregull, nuk mund të mbështetet në dispozitat e KPC-së, por vetëm si përjashtim; (iii) jurisprudenca kushtetuese nuk e ka pasur të kufizuar shqyrtimin e pretendimeve/shkaqeve të reja të individit deri në fazën e vendimmarrjes së kalimit të çështjes në seancë plenare, ndaj edhe ky interpretim i shumicës e ngushton aksesin substancial të individit.

<sup>2</sup> Ndërsa, gjyqtarja Sonila Bejtja votoi për marrjen në shqyrtim të parashtrimeve shtesë, pasi në këtë rast nuk është vendosur kalimi i çështjes për shqyrtim paraprak nga Kolegji në Mbledhjen e Gjyqtarëve dhe më pas kalimi për shqyrtim në seancë plenare, por është vendosur kalimi për shqyrtim në seancë plenare nga Kolegji i Gjykatës, pa kaluar më parë filtrin e shqyrtimit nga Mbledhja e Gjyqtarëve.

22. Për sa u përket këtyre pretendimeve (për cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit), Gjykata konstaton se kërkuësja nuk ka sjellë asnjë argument konkret dhe nuk ka arritur të provojë nga pikëpamja kushtetuese se si vendimet/qëndrimet e kundërshtuara kanë cenuar këtë parim. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se këto pretendime nuk janë argumentuar nga pikëpamja kushtetuese, ndaj nuk mund të merren në shqyrtim prej saj.

23. Gjithashtu, kërkuësja ka pretenduar cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe të së drejtës për t'u dëgjuar, duke argumentuar se: ILDKPKI-ja dhe KLGJ-ja nuk i kanë vlerësuar aktet në tërësinë e tyre, por të ndara, për të mos thënë që nuk i kanë analizuar fare; raportet e organeve tatimore janë mbajtur në vitet 2004 dhe 2006 dhe tregojnë marrëdhëniet juridike që kanë ndodhur atë kohë; duke qenë dokumentacion i mbajtur në ato vite, është e qartë se mënyra e mbajtjes së tyre nuk ka asnjë lidhje me mënyrën e vlerësimit të kandidatëve në kohën e sotme, për këtë arsye vërtetësia e tyre nuk mund të vihet në diskutim.

24. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se marrja e provave, paraqitja dhe vlerësimi i tyre janë në juridiksion të gjykimit të zakonshëm dhe jo atij kushtetues. Është vetë gjykata që vlerëson nëse provat duhet të merren dhe mënyra e vlerësimit dhe konkluzionet lidhur me to janë po ashtu në kompetencë të saj. Gjykata mund dhe duhet të investohet kur ndaj një procesi gjyqësor ka pretendime për rrugën e mënyrën e marrjes dhe fiksimit të provave, por jo të vlerësimit të tyre (*shih vendimin nr. 5, datë 09.02.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, Gjykata vëren se argumentet e kërkuëses për cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe të së drejtës për t'u dëgjuar kanë të bëjnë tërësisht me mënyrën e vlerësimit të provave nga ILDKPKI-ja dhe KLGJ-ja dhe, si të tilla, ato nuk bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues të kësaj Gjykate.

25. Për sa u përket pretendimeve të tjera të kërkuëses, konkretisht atyre që kanë të bëjnë me cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, parimit të paanshmërisë në gjykim dhe standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, Gjykata çmon se hyjnë në juridiksionin kushtetues ndaj, në vijim, do të shqyrtohet bazueshmëria e tyre në themel.

## *B. Për themelin e pretendimeve*

### *B.1. Për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj*

26. Kërkuësja ka pretenduar se gjyqtari F.K. që ka gjykuar çështjen në Gjykatën Administrative të Apelit nuk ka qenë i emëruar si gjyqtar në atë gjykatë, por ka qenë gjyqtar në gjykatën e shkallës së parë, për rrjedhojë ai nuk i kishte tagrat dhe kompetencën për të vendosur si një gjyqtar i Gjykatës Administrative të Apelit.

27. Subjekti i interesuar, KLGJ-ja, ka prapësuar se ky pretendim është i pabazuar, pasi në rastin e çështjes së kërkueses është konstatuar mungesa e padisponueshmërisë ligjore të të gjithë anëtarëve të Gjykatës Administrative të Apelit dhe për këtë arsye zëvendëskryetari i saj i është drejtuar KLGJ-së me kërkesë për caktimin e gjyqtarit për shqyrtimin e çështjes. Sipas subjektit të interesuar, ky delegim është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi.

28. Gjykata ka theksuar se gjykimi nga një gjykatë e caktuar me ligj është një nga elementet e procesit të rregullt ligjor, i sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së. Këtë parim Gjykata e ka parë të lidhur ngushtë edhe me përbërjen e trupit gjykues të ngarkuar për shqyrtimin e çdo çështjeje konkrete (*shih vendimet nr. 15, datë 11.03.2021; nr. 2, datë 29.01.2016; nr. 69, datë 17.11.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Po, ashtu, kjo Gjykatë ka theksuar se një gjykatë e caktuar me ligj duhet të plotësojë një sërë kushtesh, si mënyra e emërimit të anëtarëve apo edhe ekzistenca e garancive procedurale (*shih vendimet nr. 15, datë 11.03.2021; nr.20, datë 09.07.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

29. E drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, përfshin në vetvete edhe elementin e gjyqtarit të ligjshëm, çka do të thotë se një organ gjyqësor duhet të krijohet në përputhje me vullnetin e ligjvënësit. Kjo kërkon që një gjykatë duhet të formohet në përputhje me legjislacionin për krijimin dhe kompetencat e organeve gjyqësore, si dhe me çdo dispozitë tjetër ligjore, mosrespektimi i të cilave bën që pjesëmarrja e një ose më shumë gjyqtarëve në shqyrtimin e çështjes të jetë jo e rregullt. Parimi i gjyqtarit të ligjshëm kërkon që të respektohen dispozitat që rregullojnë procedurën e emërimit të gjyqtarëve (*shih vendimin nr. 15, datë 11.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

30. Në rastin konkret, Gjykata vëren se çështja e kërkueses është regjistruar në Gjykatën Administrative të Apelit në datën 14.09.2021. Pas regjistrimit të saj dhe hedhjes së shortit për caktimin e trupit gjykues, rezulton se disa gjyqtarë të asaj gjykate, të caktuar si anëtarë të trupit gjykues, konkretisht gjyqtarët E.M., A.G., R.L. dhe A.D., kanë kërkuar heqjen dorë nga gjykimi i çështjes, kërkesa të cilat janë pranuar respektivisht nga zëvendëskryetari i Gjykatës së Lartë dhe zëvendëskryetarja e Gjykatës Administrative të Apelit. Në kushtet kur nuk kishte gjyqtarë të tjerë për të marrë pjesë në gjykimin e çështjes së kërkueses, zëvendëskryetarja e Gjykatës Administrative të Apelit i është drejtuar me kërkesë KLGJ-së për delegimin e një gjyqtari për formimin e trupit gjykues. Në përgjigje të kësaj kërkesë, KLGJ-ja, me vendimin nr. 512, datë 26.10.2021, ka vendosur që gjyqtari i Gjykatës së Apelit Durrës, F.K., i cili ishte i komanduar në atë gjykatë sipas vendimit të po atij organi nr. 525, datë 27.10.2020, të caktohej në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës Administrative të Apelit çështjen e kërkueses.

31. Sipas nenit 45 të ligjit nr. 96/2016, magistratët në të gjitha shkallët, me të paktën një vit përvojë në funksion, mund të kandidojnë për t'u komanduar në një pozicion, në skemën e delegimit, e cila krijohet në Këshill (*pika 1*). Këshilli cakton magistratin në skemën e delegimit në bazë të nevojave të një gjykate në çdo pozicion të të njëjtit nivel ose të një niveli tjetër, për të cilin magistrati përmbush kërkesat (*pika 4, shkronja "a"*). Sipas të dhënave të faqes zyrtare të KLGJ-së rezulton se në mbledhjen e datës 27.10.2020 ajo ka vendosur përfundimin e kohëzgjatjes së komandimit si ndihmësmagjistrat në Gjykatën e Lartë të gjyqtarit F.K. dhe komandimin e tij në skemën e delegimit të gjyqtarit dhe caktimin si gjyqtar të kësaj skeme në Gjykatën e Apelit Durrës. Gjithashtu, rezulton se në datën 22.04.2021 KLGJ-ja, në vijim të procesit të ngritjes në detyrë për plotësimin e vendeve vakante në gjykatat e apelit, ka vendosur kualifikimin e gjyqtarit F.K. dhe vijimin e procedurave të emërimit për të në gjykatën e apelit.

32. Gjykata, bazuar në faktet e mësipërme (*shih paragrafin 30 të vendimit*), konstaton se në Gjykatën Administrative të Apelit, nga numri i gjyqtarëve në detyrë në kohën e regjistrimit dhe shqyrtimit të çështjes së kërkueses (pesë gjyqtarë), katër prej tyre kanë dhënë dorëheqjen nga shqyrtimi i çështjes, të cilat janë pranuar. Në vijim, për sa kohë që kishte rënë shkaku i paraqitur si pengesë nga gjyqtarja E.M., kjo gjyqtare është caktuar anëtare e trupit gjykues. Megjithatë, në situatën që sërish nuk formohej trupa prej tre gjyqtarësh për gjykimin e çështjes, ishte i nevojshëm caktimi i një gjyqtari nga skema e delegimit në kuptim të ligjit nr. 96/2016. Për rrjedhojë, delegimi i gjyqtarit në rastin konkret nga KLGJ-ja është bërë në përputhje me kompetencat e saj dhe në përputhje me parashikimet e nenit 45 të ligjit nr. 96/2016, duke deleguar dhe caktuar në Gjykatën Administrative të Apelit një gjyqtar që plotësonte kriteret ligjore.

33. Për sa më lart, Gjykata çmon se delegimi dhe pjesëmarrja e atij gjyqtari në gjykimin e çështjes së kërkueses është bërë duke respektuar dispozitat që rregullojnë procedurën e delegimit të gjyqtarëve. Pra, përbërja e trupit gjykues që ka shqyrtuar çështjen e kërkueses, në të cilën ka marrë pjesë edhe gjyqtari F.K., është formuar në mënyrë të rregullt, sipas legjislacionin në fuqi. Për rrjedhojë, në vlerësimin e Gjykatës, në rastin konkret është plotësuar elementi i gjyqtarit të ligjshëm, që në vetvete lidhet me respektimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës.

34. Për këto arsye, Gjykata çmon se pretendimi i kërkueses për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj është i pabazuar.

## *B.2. Për cenimin e parimit të paanshmërisë në gjykim*

35. Kërkesja ka pretenduar se dy nga anëtarët e trupit gjykues në Gjykatën Administrative të Apelit, konkretisht gjyqtarët E.M. dhe F.K., ishin në një marrëdhënie të posaçme me palën e paditur (KLGJ), duke qenë se kishin aplikuar për ngritje në detyrë brenda pushtetit gjyqësor. Sipas saj, ky parim është cenuar edhe nga gjyqtarja A.N., e cila ka shqyrtuar kërkesën e kërkueses për heqjen dorë nga gjykimi të gjyqtarës E.M., të bërë për shkaqe të ndryshme nga ato më sipër. Gjyqtarja A.N. ka qenë pjesë e trupit gjykues që ka shqyrtuar për herë të parë padinë e kërkueses, vendim i cili është prishur nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, duke e kthyer çështjen për rigjykim.

36. Subjekti i interesuar, KLGJ-ja, ka prapësuar se ky pretendim është i pabazuar, pasi vetëm fakti se gjyqtarët kanë aplikuar për ngritje në detyrë nuk mjafton për të mbështetur pretendimet për paanshmëri të tyre. Sipas KLGJ-së, këtij pretendimi i është dhënë përgjigje e arsyetuar nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë në mënyrë shteruese dhe se ky pretendim është hipotetik e nuk krijon dyshime të arsyeshme për paanshinë e gjyqtarit. Po ashtu, KLGJ-ja ka prapësuar se edhe pretendimi tjetër i kërkueses, që lidhet me gjyqtaren që ka shqyrtuar kërkesën për përjashtimin e gjyqtarit, nuk është i bazuar, pasi arsyeja për të cilën ka ngritur pretendimet e saj nuk përfshihet në asnjë prej dispozitave të nenit 72 të KPC-së.

37. Në nenin 42 të Kushtetutës parashikohet, ndër të tjera, se të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor dhe se kushdo, për mbrojtjen e tyre, ka të drejtën e një gjykimi nga një gjykatë e paanshme. E drejta për një gjykatë të paanshme nënkupton mungesën e paragjykimeve nga gjyqtarët në lidhje me çështjen e shtruar përpara tyre dhe që ata të mos veprojnë në mënyrë të tillë që të ndihmojnë interesat e njëres prej palëve. Një gjykatë duhet të jetë e paanshme jo vetëm formalisht, por edhe në mënyrë të shprehur. E drejta për t'u gjykuar përpara një gjykate kompetente, të pavarur dhe të paanshme të caktuar me ligj kërkon që drejtësia jo vetëm duhet të bëhet, por ajo, gjithashtu, duhet të shikohet që bëhet (*shih vendimet nr. 49, datë 16.10.2023; nr. 38, datë 15.10.2007 të Gjykatës Kushtetuese*).

38. Respektimi i parimit të paanshmërisë duhet të verifikohet duke aplikuar testin *subjektiv*, që ka të bëjë me verifikimin e bindjes apo interesit personal të një gjyqtari në një çështje të caktuar dhe testin *objektiv*, me të cilin shqyrtohet nëse gjyqtari ka ofruar garanci procedurale të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim legjitim të anshmërisë (*shih vendimet nr. 49, datë 16.10.2023; nr. 11, datë 02.04.2008; nr. 23, datë 04.11.2008 të Gjykatës Kushtetuese*). Veçanërisht për sa i përket kriterit të dytë, nëse ky kriter zbatohet për anëtarët e trupit gjykues, ai nënkupton se përveç sjelljes personale të çdo anëtari të trupit gjykues, duhet të provohet nëse ka fakte bindëse të cilat vënë në dyshim paanshmërinë. Në këtë kuadër, edhe

dukja e jashtme mund të ketë njëfarë rëndësie. Në përcaktimin nëse një çështje konkrete ka arsye logjike për të dyshuar se një gjyqtar nuk është i paanshëm, këndvështrimi i atyre që ankohen për diçka të tillë është i rëndësishëm, por jo vendimtar. Në fakt, vendimtare është nëse objektiviteti i këtyre dyshimeve është mjaftueshmërisht i bazuar (*shih vendimin nr. 49, datë 16.10.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

39. Në rastin konkret, Gjykata, nisur nga natyra e pretendimeve të kërkuases, vlerëson se duhet t'i trajtojë ato për secilin gjyqtar të Gjykatës Administrative të Apelit si në testin *objektiv*, ashtu dhe në testin *subjektiv* për të arritur në konkluzionin nëse ka pasur cenim të parimit të paanshmërisë.

40. Gjykata vëren se gjyqtarët E.M. dhe F.K., të cilët kanë qenë në përbërje të trupit gjykues që ka shqyrtuar çështjen e kërkuases, kanë aplikuar pranë KLGJ-së për ngritje në detyrë. Në përfundim të këtyre procedurave, referuar të dhënave të faqes zyrtare të KLGJ-së, rezulton se me vendimin e datës 01.11.2022 ajo ka vendosur ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar të gjyqtarit F.K., kurse me vendimin e datës 28.04.2023 ka miratuar propozimin e gjyqtarës E.M. për emërim në Gjykatën e Lartë.

41. Gjykata evidenton se sipas nenit 147, pika 1, të Kushtetutës, KLGJ-ja ka përgjegjësinë për të siguruar jo vetëm pavarësinë dhe përgjegjshmërinë e pushtetit gjyqësor, por edhe mbarëvajtjen e tij, e cila sipas ligjit nr. 96/2016 lidhet edhe me çështjet e emërimit, transferimit, delegimit ose ngritjes në detyrë të gjyqtarëve, duke qenë se këta të fundit janë subjekte të veprimtarisë funksionale që ajo ushtron. Për rrjedhojë, bazuar në përgjegjësitë kushtetuese të KLGJ-së, ashtu edhe në situatën faktike ku gjyqtarët në mënyrë sistematike vlerësohen profesionalisht në kuptim të ligjit nr. 96/2016, përfshihen në skemat e delegimit si dhe në sistemin e karrierës, me qëllim ngritjen e tyre në detyrë, vetëm fakti që këta dy gjyqtarë në kohën e shqyrtimit të çështjes kanë qenë pjesë e procedurave për promovimin e tyre që zhvillohen nga KLGJ-ja, nuk është në vetvete i mjaftueshëm për të vënë në dyshim njëanshmërinë e tyre. Marrëdhënia e KLGJ-së me gjyqtarët që kanë marrë pjesë në shqyrtimin e çështjes së kërkuases, nuk është marrëdhënie personale në kuptim të nenit 72 të KPC-së, por marrëdhënie sistematike, për rrjedhojë nuk mund të përfshihet në ato shkaqe që kanë të bëjnë me pasjen e interesit për çështjen në gjykim apo që lidhen me arsye serioze njëanshmërie.

42. Për sa më sipër, Gjykata çmon se kërkuësja nuk ka paraqitur ndonjë provë ose fakt bindës që të vërë në dyshim paanshmërinë e gjyqtarëve E.M. dhe F.K. dhe nuk ka arritur të provojë se si vlerësimi i tyre ka ndikuar në vendimmarrje. Në këto kushte, në mungesë të provave të paraqitura nga kërkuësja në këtë drejtim, nuk ka arsye për të vënë në dyshim



paanshmërinë e këtyre gjyqtarëve dhe për të besuar se ata kanë pasur interes të drejtpërdrejtë në zgjidhjen e çështjes gjyqësore midis kërkueses dhe KLGJ-së. Për më tepër, Gjykata konstaton se këto pretendime të kërkueses kanë marrë përgjigje të arsyetuar, shteruese, nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë.

43. Ndërsa për sa i përket pretendimit për gjyqtaren A.N., Gjykata konstaton se vendimmarrjet në të cilat ajo ka marrë pjesë janë të një natyre krejtësisht të ndryshme. Në rastin e parë të gjykuar nga gjyqtarja A.N. ajo ka marrë pjesë në shqyrtimin e ankimit të kërkueses kundër vendimit të KLGJ-së, ku ka shqyrtuar themelin e pretendimeve të saj, ndërsa në rastin e dytë ka marrë pjesë në shqyrtimin e kërkesës për heqjen dorë nga shqyrtimi i çështjes të gjyqtares E.M., që nuk ka asnjë lidhje me procesin gjyqësor ku ka qenë pjesë dhe ku është shprehur për themelin e pretendimeve të kërkueses. Ajo gjyqtare ka shqyrtuar vetëm nëse në rastin konkret ndodhej para rastit të ekzistencës së kritereve që e detyrojnë gjyqtarin të heqë dorë nga gjykimi i një çështjeje të caktuar. Kërkuesja, për më tepër, nuk ka paraqitur ndonjë provë për të argumentuar se si vlerësimi i bërë nga gjyqtarja A.N. për kërkesën e gjyqtares E.M. për heqjen dore nga shqyrtimi i çështjes ka ndikuar në vendimmarrjen e Gjykatës Administrative të Apelit.

44. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkueses për cenimin e parimit të paanshmërisë në gjykim janë të pabazuara.

### *B.3. Për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*

45. Kërkuesja ka pretenduar se nga përmbajtja e vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit nuk rezulton se ka një vendimmarrje konkrete, për shkak të pasjes së tre mendimeve të ndryshme, shumicë, kundër dhe paralel. Në këtë kuptim, sipas saj, vendimi i gjykatës së apelit nuk rezulton të jetë i arsyetuar. Ajo ka pretenduar se edhe pse e ka ngritur këtë pretendim në rekurs, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk ka mbajtur një qëndrim, duke mos arsyetuar në lidhje me zbatueshmërinë e nenit 307, paragrafi i tretë, të KPC-së. Gjithashtu, kërkuesja ka pretenduar se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në pjesën hyrëse të vendimit të tij, nuk ka pasqyruar të gjitha pretendimet e ngritura prej saj në rekurs dhe mënyra e arsytimit të tij vjen në kundërshtim me jurisprudencën kushtetuese. Konkretisht, sipas kërkueses, në vendimin e Kolegjit Administrativ nuk janë parashtruar pretendimet për cenimin e parimit të paanshmërisë nga gjyqtarja A.N. dhe të së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj nga gjyqtari F.K.

46. Subjekti i interesuar, KLGJ-ja, ka prapësuar se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë u ka dhënë përgjigje shteruese pretendimeve të kërkueses për cenimin e procesit të

rregullt ligjor dhe pretendimet e saj janë pasqyruar në mënyrë të përmbledhur në vendim, si dhe janë trajtuar në vendimin e kundërshtuar, i cili plotëson kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese. Sipas subjektit të interesuar, edhe vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit i plotëson këto kritere, pasi ai është marrë me shumicë votash, ku një nga anëtarët ka qenë me mendim pakice, ndërsa një tjetër, i cili ka qenë në shumicë, ka arsyetuar me mendim paralel. Në këtë kuptim, sipas KLGJ-së, vendimi i gjykatës së apelit është marrë me shumicën e nevojshme të votave të gjyqtarëve.

47. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funkzioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Zbatimi i këtij standardi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre (*shih vendimet nr. 9, datë 23.02.2023; nr. 11, datë 21.04.2022; nr. 10, datë 04.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

48. Për sa u përket vendimeve të Gjykatës së Lartë, Gjykata ka theksuar se kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i asaj gjykate. Kur në rekurs janë ngritur pretendime të natyrës kushtetuese, Gjykata e Lartë, bazuar në natyrën e gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, si dhe në parimin e subsidiaritetit që udhëheq raportet ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, duhet të investohet në ekzaminimin e tyre dhe të mbajë një qëndrim të shprehur lidhur me to (*shih vendimet nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 6, datë 16.02.2021; nr. 11, datë 16.04.2018 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, në rastet kur pretendimet me natyrë kushtetuese të paraqitura në rekurs nuk gjejnë pasqyrim në vendimin e Gjykatës së Lartë dhe atyre nuk u jepet përgjigje, arsyetimi i vendimit të asaj gjykate nuk ka përmbushur një ndër funksionet e tij, konkretisht të drejtën e individit për t'u dëgjuar për të gjitha pretendimet e ngritura (*shih vendimin nr. 19, datë 07.07.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

49. Gjykata vëren se vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit, me të cilin në përfundim të gjykimit është vendosur rrëzimi i kërkesëpadisë së kërkueses (paditëses), përveç arsyetimit të tij përmban edhe mendimin pjesërisht kundër dhe arsyetimin paralel të njërit gjyqtar, si edhe mendimin e pakicës të një gjyqtari tjetër. Kërkuësja, në rekurs ka pretenduar se për sa kohë që vendimmarrja e kundërshtuar e gjykatës së apelit nuk ka një shumicë,

konsiderohet se ajo nuk ka një vendim të arsyetuar në lidhje me pretendimet e saj të ngritura në kërkesëpadi. Për rrjedhojë, për shkak të mënyrës se si kanë votuar gjyqtarët e trupit gjykues në gjykatën e apelit dhe mënyrës së arsyetimit të atij vendimi, kërkesja ka parashtruar si shkak në rekurs edhe se ajo nuk ka marrë një përgjigje përfundimtare në lidhje me pretendimet e saj, ndërkohë që gjykata e apelit duhej të kishte vepruar sipas parashikimit të nenit 307 të KPC-së.

50. Gjykata vëren, gjithashtu, se në ankimin kushtetues individual kërkesja ka referuar një çështje tjetër të shqyrtuar nga Gjykata e Lartë, e cila e ka zgjidhur atë bazuar në interpretimin e nenit 307 i KPC-së (*shih vendimin nr. 00-2022-1717 (265), datë 07.07.2022 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë*). Duke iu referuar asaj çështjeje, Gjykata vëren se një ndër shkaqet e rekursit, me të cilin është vënë në lëvizje Gjykata e Lartë, ka qenë edhe mënyra e arsyetimit të gjyqtarëve të gjykatës së apelit, e parë kjo në lidhje me dispozitivin e vendimit. Në atë rast Gjykata e Lartë ka konstatuar tre qëndrime të ndryshme në vendimin e kundërshtuar, çka bënte të pamundur të kuptohej zgjidhja e çështjes konkrete dhe duke e shqyrtuar pretendimin në këndvështrim të standardit të arsyetimit, në interpretim të nenit 307 të KPC-së, ajo ka analizuar në lidhje me mendimin paralel se ai “*nuk mund të synojë një disponim të ndryshim mbi mosmarrëveshjen në gjykim. Pra mendimi paralel ka një qasje ndryshe në arsyetimin e vendimit për mënyrën e interpretimit të ligjit, e cila kurrsesi nuk mund të çojë në një zgjidhje të ndryshme të çështjes. Qëllimi i mendimit paralel është të pasurojë jurisprudencën me mënyra alternative dhe novatore të kuptimit të ligjit, të cilat mbështesin në mënyrë të plotë urdhërimet e dispozitivit, por jo të kundërshtojnë dispozitivin e vendimit gjyqësor*” (*shih paragrafin 50 të vendimit nr. 00-2022-1717 (265), datë 07.07.2022 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë*). Pra, në konkluzion Gjykata e Lartë ka vënë theksin te harmonia dhe koherenca që duhet të ekzistojë mes pjesës arsyetuese dhe asaj urdhëruese të vendimit, mungesa e së cilës vë në dyshim legjitimitetin e vendimit gjyqësor. Për rrjedhojë, në atë rast Gjykata e Lartë e ka konsideruar të pavlefshëm vendimin e gjykatës së apelit dhe në përfundim të gjyqimit ka vendosur prishjen e tij dhe kthimin e çështjes për rigjykim.

51. Gjykata vëren se në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë kërkesja, përveç pretendimit për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, ka ngritur edhe disa pretendime të tjera me natyrë kushtetuese, siç është ai për cenimin e parimit të paanshmërisë në gjykatën e apelit dhe të së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj. Kolegji Administrativ ka vlerësuar se shkaqet e parashtruara në rekurs nuk ngrenë problematika të zbatimit të gabuar të ligjit të një rëndësie themelore për njësimin, sigurinë ose zhvillimin e praktikës gjyqësore, nuk parashtrojnë një qëndrim të ndryshëm të gjykatës së faktit nga vendimmarrje të mëparshme të Kolegjit Administrativ, si dhe nuk konstatohet që gjykimi i

zhvilluar pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë të ketë pasur shkelje të rënda procedurale me pasojë pavlefshmërinë e vendimit ose procedurës së gjykimit. Sipas Kolegjit Administrativ janë zbatuar detyrat e Gjykatës së Lartë në lidhje me riçeljen e hetimit gjyqësor, duke marrë në shqyrtim aktin e ekspertimit të kërkuar nga pala paditëse, ndërsa vlerësimi i aktit në raport me provat e tjera nga gjykata në funksion të vendimmarrjes së saj, ka të bëjë me vlerësimin e provave, vlerësim i cili del jashtë funksionit të Gjykatës së Lartë (*shih paragrafin 41 të vendimit të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë*).

52. Për sa u përket pretendimeve me natyrë kushtetuese të parashtruara nga kërkuesja në rekurs, rezulton se Kolegji Administrativ i ka dhënë përgjigje vetëm atij për cenimin e parimit të paanshmërisë, duke e vlerësuar të pabazuar. Për sa i përket pretendimit me natyrë kushtetuese për arsyetimin e vendimit të gjykatës së apelit, të lidhur me mungesën e harmonisë dhe koherencës ndërmjet pjesës arsyetuese dhe asaj urdhëruese të tij, Gjykata e Lartë nuk e ka marrë në shqyrtim dhe nuk i ka dhënë përgjigje në pjesën arsyetuese të vendimit, por është mjaftuar me pasqyrimin e tij vetëm në pjesën hyrëse të vendimit. Për rrjedhojë, kërkuesja ka vënë në diskutim respektimin e standardit të arsyetimit edhe nga Gjykata e Lartë, duke pretenduar se në çështjen e saj ishte e nevojshme që ajo gjykatë, në ushtrim të funksionit të saj si gjykatë e ligjit, të bënte interpretimin e nenit 307 të KPC-së, me qëllim zgjidhjen përfundimtare të çështjes konkrete.

53. Gjykata ka theksuar se interpretimi i ligjit, duke përcaktuar përmbajtjen e tij, është atribut i organeve që e zbatojnë atë dhe, nisur nga ky parim, sqarimi i kuptimit ose interpretimi i çdo dispozite ligjore të zbatueshme gjatë shqyrtimit të një çështjeje të caktuar është në kompetencë të gjykatave të sistemit të zakonshëm gjyqësor (*shih vendimet nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 2 datë 11.02.2021; nr. 1, datë 20.01.2012 të Gjykatës Kushtetuese*). Po kështu, në vlerësimin e Gjykatës është detyrë e Gjykatës së Lartë që, në përputhje me funksionin e saj si gjykatë ligji dhe në kuptim të parimit të subsidiaritetit, t'u japë përgjigje pretendimeve me natyrë kushtetuese në rastet kur gjykatat më të ulëta nuk kanë kryer funksionin e tyre për interpretimin e ligjit të zbatueshëm (*shih vendimet nr. 25, datë 09.04.2024; nr. 19, datë 07.07.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

54. Në përputhje me standardet e mësipërme, si edhe bazuar në vetë praktikën e Gjykatës së Lartë në raste të ngjashme, Gjykata vlerëson se për shkak të natyrës së pretendimeve të parashtruara në rekurs, ajo gjykatë duhej të kishte mbajtur qëndrim të shprehur në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e nenit 307 të KPC-së, në mënyrë që t'i jepte përgjigje të arsyetuar pretendimit të kërkueses për respektimin e së drejtës për proces të rregullt në aspekt të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor. Gjykata vlerëson se për shkak se mungesa e

arsyetimit në vendimin e Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, në lidhje me mënyrën e zbatimit dhe interpretimit të nenit 307 të KPC-së, vë në dyshim respektimin e standardit të arsyetimit nga ana e Gjykatës së Lartë, pretendimi i kërkueses për cenimin e së drejtës për proces të rregullt është i bazuar.<sup>3</sup>

55. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkueses për cenimin e parimit të paanshmërisë në gjykim dhe së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj janë të pabazuara, ndërsa pretendimi për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë është i bazuar, sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi, ndaj kërkesa pranohet pjesërisht.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe neneve 31/b, pika 1, 71 dhe 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

### **V E N D O S I:**

1. Pranimin pjesërisht të kërkesës.
2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2023-762, datë 09.03.2023 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën.
3. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

**Marrë më 11.04.2024**

**Shpallur më 16.05.2024**

---

<sup>3</sup> Gjyqtarët Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Genti Ibrahimimi dhe Marjana Semini votuan për cenimin e këtij standardi edhe nga vendimmarrja e Gjykatës Administrative të Apelit dhe, për rrjedhojë, duke qenë se shkelja është kryer nga ajo gjykatë, votuan edhe për kthimin e çështjes për rigjykim në gjykatën e apelit.